

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i Hashim Thaçit

Data: 14 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake lidhur me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe me Pretendimet për Shkeljen e të Drejtave

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtja e Hashim Thaçit

Dejvid Huper

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

I. PARASHTRIMET

A. PRETENDIMI PËR PAPRANUESHMËRI

1. Në pajtim me nenin 6(1) të KEDNJ-së,¹ 'një gjykatë apo tribunal *gjithmonë* duhet "të themelohet me ligj".² Pretendimi për papranueshmëri nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS")³ në lidhje me kundërshtimin e ligjshmërisë së DHSK-së që ka ngritur Mbrojtja e z. Hashim Thaçi ("Mbrojtja")⁴ nuk përputhet me faktin se çdo organ gjyqësor duhet të përmbushë kriteret e 'krijimit me ligj' apo të pavarësisë gjyqësore në pajtim me nenin 6(1) të KEDNJ-së. Rregulla 97(1)(a) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja") nuk mund të shkelë Kushtetutën e cila siguron zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të KEDNJ-së dhe epërsinë e saj 'mbi dispozitat e tjera ligjore dhe aktet e tjera të institucioneve publike'.⁵ Për më tepër, nga e drejta themelore për të kërkuar mjet juridik efektiv nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar më herët me ligj që garantohet nga KEDNJ-ja, rrjedh se çdokush, në parim, duhet të ketë mundësi të ankohet se kjo e drejtë është shkelur në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.⁶

¹ European Convention on Human Rights ("ECHR").

² European Court of Human Rights ("ECtHR"), *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland*, 26374/18, Grand Chamber, Judgment, 1 December 2020 ("*Guðmundur Judgment*"), para. 211 (emphasis added).

³ KSC-BC-2020-06/F00260, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake lidhur me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe me Pretendimet e Shkeljes së të Drejtave, 23 prill 2021 ("*Përgjigja e ZPS-së*"), para. 2.

⁴ KSC-BC-2020-06/F00217, Mocion për Kundërshtimin e Juridiksionit mbi Bazën e Shkeljes së të Drejtave Themelore të Mishëruara në Kushtetutë, 12 mars 2021 ("*Kërkesa e Thaçit*"), para. 36-51.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës ("*Kushtetuta*"), neni 22(2).

⁶ Në këtë përfundim arriti kohët e fundit Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ("GJED") pas shqyrtimit të gjerësishëm të jurisprudencës së GJEDNJ-së: *shih ECJ, Review Simpson and HG v Council and Commission*, C-542/18 RX-II and C-543/18 RX-II, ECLI:EU:C:2020:232, Grand Chamber, Judgment of the Court, 26 March 2020, para. 57: 'garancia e qasjes ndaj një tribunali të pavarur dhe të paanshëm të themeluar më parë me ligj, dhe sidomos atyre që vendosin se çfarë është tribunali dhe përbërja e tij, është në themel të së drejtës për gjykim të drejtë. Kjo do të thotë se çdo gjykatë është e detyruar të verifikojë nëse, në përbërjen që ka, ai është tribunal i atillë që të ketë dyshime serioze lidhur me atë pikë. Ky verifikim është i nevojshëm për besueshmërinë që duhet të kenë gjykatat në një shoqëri demokratike në radhët e popullatës që është nën juridiksionin e tyre.'

B. SHKELJA E SË DREJTËS PËR GJYKIM NGA NJË TRIBUNAL I PAVARUR DHE I PAANSHËM I THEMELUAR ME LIGJ

1. Kushtetutshmëria e DHSK-së

2. Pretendimi i ZPS-së se Gjykata Kushtetuese e Kosovës (“GJKK”) e ka përcaktuar tashmë se DHSK-ja është në përputhje me Kushtetutën⁷ nuk merr parasysh faktin se ligji me atë të të cilit është themeluar DHSK-ja nuk ka qenë objekt i vlerësimit ri kushtetues. Çka është me rëndësi, neni 162(1) i Kushtetutës përcakton se “[...] Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.” Rrjedhimisht, Aktgjykimi i GJKK-së ishte vetëm në lidhje me vendimin mbi përputhshmërinë e idesë së gjykatës së specializuar, jo mbi Gjykatën që u themelua më pas.

3. Gjithashtu, Aktgjykimi i GJKK-së e përkufizoi nocionin e ‘gjykatës së jashtëzakonshme’ pa u mbështetur në ndonjë konstatim nga jurisprudenca e njohur. Domethënës është fakti se interpretimi i ‘themelimit me ligj’ nga GJKK-ja i *paraprin* aktgjykimin të 1 dhjetorit 2020 të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së në të cilin Gjykata përpunoi dhe sqaroi ‘kuptimin që duhet të ketë koncepti i një “tribunali të themeluar me ligj”, dhe analizoi ndërlidhjen e tij me “kriteret institucionale” shtesë sipas nenit 6 § 1, konkretisht, ato për pavarësi dhe paanësi.⁸

2. Mosmarrja parasysh e jurisprudencës më të fundit të GJEDNJ-së

4. ZPS-ja nuk e përmend aktgjykimin kryesor të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së të 1 dhjetorit 2020, le më ta analizojë. Është shqetësuese kjo mangësi sidomos po të

⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 3-8, që i referohet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Vlerësim i Amendamentit të Republikës së Kosovës Propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe dërguar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 9 mars 2015 me Letrën nr. 05-433/DO-318, Aktgjykimi i Çështjes nr. KO26/15 (“Aktgjykimi i GJKK-së”).

⁸ *Guðmundur Judgment*, para. 218.

shihet në kuadrin e mbështetjes së ZPS-së në një vendim të vitit 1978 të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, që ka të bëjë me sistemin austriak të gjykatave të punës, për të argumentuar se nuk ka nevojë që një ligj të normatizojë ‘çdo gjë në imtësi’ që të përmbushë kriterin e ‘themelimit me ligj’. Vendimi i vitit 1978 nuk krijon precedent dhe, sidoqoftë, nuk vlen për të vlerësuar nëse janë përmbushur kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së nga një tribunal modern, hibrid dhe penal siç është DHSK-ja, e cila punëson vetëm gjykatës dhe nëpunës ndërkombëtarë, nuk ka gjykatës të Kosovës në panelet gjyqësore dhe, përveç emrit, nuk ka asnjë lidhje apo bashkëveprim me gjykatat në Kosovë.

5. Në vend që ta bëjë një gjë të tillë, ZPS-ja i referohet interpretimit që GJKK-ja u ka bërë tre kritereve⁹ të cilat ZPS-ja kishte vendosur t’i shfrytëzonte për vlerësimin e kushtetutshmërisë së DHSK-së, pa shpjeguar se deri në ç’masë ato përmbushnin kriterin e ‘themelimit me ligj’ që përshkruhet në Aktgjykimin *Guðmundur* – çështja gjyqësore që përmban interpretimin më të fundit të kritereve të detyrueshme për t’u zbatuar. Fakti se themelimi i DHSK-së ‘ishte paraparë përmes Shkëmbimit të Letrave’¹⁰ është tërësisht jorelevant për të vlerësuar nëse (i) DHSK-ja është gjykatë e jashtëzakonshme dhe/ose (ii) përmbush kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së. Në mënyrë të ngjashme, përmendja e disa aktgjykimeve të GJKK-së në lidhje me Rregulloren¹¹ nuk tregon se DHSK-ja është në përputhje me Kushtetutën e, në veçanti, me kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së.

6. ZPS-ja rikujton se GJKK-ja i referohet aktgjykimit të GJEDNJ-së në çështjen *Fruni kundër Sllovakisë*¹² por, megjithatë, nuk përmend çështjen *Erdem kundër Gjermanisë* në të cilën është mbështetur gabimisht GJKK-ja, siç është parashtruar më parë.¹³ Sa i

⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 11.

¹⁰ *Po aty*, para. 12.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*, poshtëshënimi 39.

¹³ Kërkesa e Thaçit, para. 42.

përket çështjes *Fruni*, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë kishte konstatuar se organi relevant vendor ishte themeluar *duke shkelur* Kushtetutën e Sllovakisë pasi kishte tipare të përziera të një gjykate të specializuar dhe të një gjykate të jashtëzakonshme. Më tej, vlerësimi kushtetues *in abstracto* nuk mund të barazohet me vlerësimin *in concreto* të GJEDNJ-së e cila vlerëson, rast pas rasti, nëse është shkelur KEDNJ-ja. Fakti se GJEDNJ-ja konstatoi se në çështjen *Fruni* nuk ishte shkelur neni 6(1) i KEDNJ-së nuk mund të barazohet me pohimin e përgjithësuar se gjykatat penale të specializuara janë gjithnjë në përputhje me KEDNJ-në, e aq më pak se DHSK-ja i përngjan organit sllovak, i cili, gjithsesi, u konstatua se ishte jokushtetues.

3. Moskuptimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe i procesit të vlerësimit kushtetues

7. ZPS-ja po ashtu ka keqkuptuar interpretimin e GJEDNJ-së për kriterin e 'krijimit me ligj' duke u mbështetur, ndër të tjera, në një vendim të vitit 1978 të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut.¹⁴ Thjesht miratimi i një ligji që rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin¹⁵, në vetvete, nuk parandalon shkeljen e këtij kriteri pavarësisht se sa i hollësishëm është ligji në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, fakti se GJKK-ja kishte në dispozicion 'me tepri komente mbi amendamentet e propozuara kushtetuese'¹⁶ nuk do të thotë automatikisht se ligji që ka krijuar DHSK-në nuk ka shkelur kriteret e KEDNJ-së.

8. Për këtë arsye, është e vështirë të kuptohet se si mund të pretendojë ZPS-ja se 'të gjitha aspektet relevante në dispozicion të GJKK-së në kohën e aktgjykimit' dhe se '[ë]shtë jorelevant nëse vetë Ligji i ishte dërguar GJKK-së për shqyrtim'.¹⁷ Vlerësimi kushtetues i legjislacionit nuk konsiderohet i përfunduar apo 'jorelevant' vetëm sepse

¹⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 13 dhe poshtëshënimi. 38.

¹⁵ *Po aty*, para. 5.

¹⁶ *Po aty*, para. 7.

¹⁷ *Po aty*, para. 8.

disa aspekte të një ligji të pamiratur deri në atë kohë doli se ishin pjesë e 'dokumenteve të paidentifikuara që ishin në shqyrtim nga GJKK-ja në periudhën relevante'.¹⁸ Vlerësimi kushtetues i legjislacionit nuk bëhet kështu në asnjë vend demokratik që bazohet mbi sundimin e ligjit.

4. Përshkrimi i gabuar i jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe analiza që ofron Mbrojtja

9. ZPS-ja e akuzon gjithashtu Mbrojtjen se 'vendosi të mos përmendte' çështjen *Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*,¹⁹ të vitit 2013 dhe pretendon se vendimi i GJEDNJ-së në këtë çështje gjyqësore ka të bëjë me një 'gjykatë në gjendje të njëjtë, që ishte dhoma e krimeve të luftës krijuar brenda gjykatës shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës'.²⁰ Së pari, në rast se vërtet kjo ishte 'çështja më relevante e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së në këtë aspekt'²¹ siç pretendon ZPS-ja, atëherë do të ishte dashur që GJKK-ja ta shqyrtonte atë. Ajo nuk e bëri një gjë tillë. Së dyti, kjo çështje gjyqësore nuk trajton as gjykatat e jashtëzakonshme kundrejt gjykatave të specializuara, as kriterin e 'themelimit me ligj', gjë që shpjegon pse nuk ndodhet në Aktgjykimin e GJKK-së. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Bosnjës nuk ndalon krijimin e gjykatave të jashtëzakonshme, ndryshe nga Kushtetuta e Kosovës. Së treti, ZPS-ja pretendon në mënyrë të gabuar se Aktgjykimi *Maktouf dhe Damjanović* paraqet 'në hollësi kërkesat ligjore për pavarësi dhe paanësi'.²² Kjo është e pasaktë. Në fakt, në çështjen kryesore mbi pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit, GJED-ja nuk i referohet në as edhe një rast çështjes *Maktouf dhe Damjanović* gjatë paraqitjes së pasqyrës së hollësishme të jurisprudencës së GJEDNJ-së.²³

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina*, 2312/08 and 34179/08, Grand Chamber, Judgment, 18 July 2013 (*"Maktouf and Damjanović Judgment"*).

²⁰ Përgjigjja e ZPS-së, poshtëshënimi 60.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*.

²³ Paragrafët kryesorë nga aktgjykimi i Dhomës së Madhe të GJED-së të 19 nëntorit 2019 përsëriten në Aktgjykimin *Guðmundur*, para. 138.

10. Është me rëndësi se në Aktgjykimin *Maktouf dhe Damjanović* GJEDNJ-ja theksoi se gjykatësit ndërkombëtarë janë emëruar ‘mbi bazën e një rekomandimi nga figurat më të larta të gjyqësorit në Bosnjë - Hercegovinë’.²⁴ Me këtë përfundim, GJEDNJ-ja mbështeti arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës lidhur me emërimin e gjykatësve ndërkombëtarë në Gjykatën Shtetërore sipas të cilit ishte ‘me rëndësi të veçantë që Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë, organ i pavarur kompetent për emërimin e gjykatësve vendorë, të kishte rol në procedurën e emërimit’.²⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor i Kosovës nuk luan këtë rol sa i përket DHSK-së. Në fund, Aktgjykimi *Maktouf dhe Damjanović* nuk ofron vlerësim të kriterëve në lidhje me ‘krijimin me ligj’, dhe analiza përqendrohet në pavarësinë e dhomave të krimeve të luftës të Gjykatës Shtetërore të BeH sipas kuptimit të nenit 6(1) të KEDNJ-së.

5. Gjykatë e jashtëzakonshme

11. Në përgjithësi, ZPS-ja nuk përgjigjet ndaj argumenteve të Kërkesës së Thaçit lidhur me natyrën e jashtëzakonshme të DHSK-së, përveç pohimit se DHSK-ja përbëhet nga dhoma të specializuara dhe nuk është gjykatë e jashtëzakonshme.²⁶ Për të justifikuar themelimin e DHSK-së, ZPS-ja i referohet përmbushjes së pretenduar të një detyrimi ndërkombëtar bazuar mbi Raportin e Martit,²⁷ mirëpo një raport nuk ka vlerë detyruese ligjore dhe nuk përbën marrëveshje ndërkombëtare. Si përgjigje ndaj parashtrimeve se DHSK-ja është ‘unike’ apo ‘e paprecedent në historinë e drejtësisë penale moderne’,²⁸ ZPS-ja u referohet juridiksioneve ‘shumë më të kufizuara se ai i DHSK-së’ dhe përmend, ndër të tjera, Dhomat e *Jashtëzakonshme* Afrikane.²⁹ Një gjë e

²⁴ *Maktouf and Damjanović* Judgment, para. 51.

²⁵ *Shih* para. 46 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës të 30 marsit 2007, përsëritur në Aktgjykimin *Maktouf dhe Damjanović*, para. 15.

²⁶ Përgjigja e ZPS-së, para. 12 dhe f. 2.

²⁷ *Po aty*, para. 18.

²⁸ *Shih* KSC-BC-2020-06/F00224, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljeve të Kushtetutës, 15 mars 2021, para. 9. *Shih gjithashtu* parashtrimet e paraqitura me Kërkesën e Thaçit, para. 40 dhe 49.

²⁹ Përgjigja e ZPS-së, para. 20 (theksimi i shtuar).

tillë mund të kuptohet si pranim i paqëllimshëm se DHSK-ja ka juridiksion më të gjerë se një gjykatë penale e jashtëzakonshme, ndërkohë që gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara nga Kushtetuta e Kosovës.

12. Qëndrimi i shprehur në Kërkesën e Thaçit lidhur me largimin dhe zëvendësimin e z. Shvendiman është quajtur ‘parashtrim i rremë’ për shkak se, sipas ZPS-së, ‘është publikisht e njohur se Prokurori i Specializuar i mëparshëm u largua nga ZPS-ja në përfundim të kontratës’.³⁰ Rrethanat e largimit të tij 18 muaj pasi kishte nisur mandatin katërvjeçar,³¹ mbeten po aq të mjegullta sa edhe parashtrimet e ZPS-së për këtë pikë. ZPS-ja citon ‘njoftimet publike’, pa bërë asnjë përpjekje për t’u treguar palëve ose Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ku gjendet sqarimi i këtij aspekti.

13. Në rast se me ‘kontratë me afat të caktuar’ ZPS-ja i referohet kontratës së një ‘zyrtari të lartë të Shërbimit të Jashtëm’ të SHBA-së, atëherë ky është problem. Të gjitha palët e interesuara, përfshirë Departamentin e Shtetit të SHBA-së, BE-në, dhe vetë Prokurorin e Specializuar të mëparshëm, kanë pasur dijeni për statusin e tij në SHBA në kohën kur ai është emëruar për një mandat katërvjeçar në ZPS. Prokurori i Specializuar i mëparshëm ra dakord ta pranonte postin vetëm “me kusht që të garantohej pavarësia financiare dhe politike dhe që ai të mund të shërbente gjatë gjithë mandatit katërvjeçar deri në vitin 2020”.³² Në rast se, siç pretendoi vetë, ai ishte vërtet

³⁰ *Po aty*, poshtëshënimi. 52.

³¹ Z. Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar më 1 shtator 2016 dhe u largua më 31 mars 2018: *shih* Komunikatën për Shtyp të DHSK-së, ‘Dejvid Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar’, 5 shtator 2016; Komunikatë për Shtyp e DHSK-së, ‘Prokurori i Specializuar shpjegon largimin e tij të shpejtë’, 15 shkurt 2018 (“Komunikata për Shtyp mbi Largimin”). *Shih gjithashtu*, nenin 35(8), të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), ku përcaktohet se: “Prokurori i Specializuar shërben për një mandat katërvjeçar dhe gëzon të drejtën e rëmëimit..”

³² Julian Borger, *The Guardian*, ‘Kosovo: top war crimes prosecutor forced to leave amid US state department inertia’(‘Kosovë: Detyrohet të largohet Prokurorori i Lartë i Krimeve të Luftës mes inercisë në Departamentin e Shtetit’), 28 shkurt 2018 (Artikulli i *The Guardian*).

një “pensionist të cilit i ishte kërkuar kthimi në punë”,³³ kontrata me afat të caktuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së ishte thjesht një instrument për caktimin e tij përmes autoriteteve shtetërore në post në ZPS, dhe nuk do ta kishte penguar për të përfunduar mandatin. Kjo nuk shpjegon as detyrimin e menjëhershëm për respektimin e përfundimit të mandatit e as ‘heshtjen’ që pasoi kërkesën për shpjegim që Prokurori i Specializuar i mëparshëm bëri në Departamentin e Shtetit të SHBA-së.³⁴ Sidomos duke pasur parasysh se nuk ishte caktuar pasardhësi i tij.³⁵

14. Ajo që dihet është se Prokurori i Specializuar i mëparshëm tha si më poshtë gjatë një fjalimi në Universitetin e Lajdenit në mars 2018, d.m.th. pasi ishte njoftuar për shkarkimin e tij.³⁶ Pasi foli për mandatin e ngushtë të ZPS-së, rëndësinë e integritetit të prokurorisë, dhe standardet e lëshimit të aktakuzave, ai tha: “nuk duhet të premtojmë asnjëherë më shumë se ç’mund të arrihet e as më shumë se sa na lejon mandati e burimet financiare”, dhe se “[d]onatorët që kanë qëllime të mira duhet të mos i bëjnë më të cënueshme institucionet si Zyra e Prokurorit për shkak se nuk arrijnë të kuptojnë natyrën e hetimeve dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe presin më shumë se duhet nga ato institucione.”³⁷ Në rast se këto deklarata nuk janë tërësisht abstrakte, ato tregojnë, më së paku, se Prokurori i Specializuar i mëparshëm kishte pasur mospajtim me donatorët si rezultat i pritshmërive të tyre.

15. Sidoqoftë, problemi i identifikuar është si vijon: edhe sikur Prokurori i Specializuar i mëparshëm të jetë shkarkuar nga posti pas përfundimit të një kontrate

³³ *Shih* Komunikatën për Shtyp mbi Largimin, ku z. Shvendiman deklaroi: “Kjo duhet të ndodhë sepse administrata amerikane nuk mund të bëjë përjashtim për statusin tim si pensionist i rimarrë në shërbim, diçka që ligji nuk më lejon të ndryshoj, pavarësisht nga sa shumë mund të dëshiroj të qëndroj.”

³⁴ Artikulli në *The Guardian*.

³⁵ *Po aty*: “Mirëpo vetëm para dy javësh mori vesh se duhej të largohej para prillit, duke mos pasur kohë reale për të gjetur zëvendësues. Shvendiman tha se nuk e dinte nëse kishte filluar kërkimi për pasardhësin.”

³⁶ Dejvid Shvendiman, Universiteti i Lajdenit, ‘Mendime për periudhën time si Prokuror i Specializuar dhe sfidat e së ardhmes’, 22 mars 2018.

³⁷ *Po aty*, f. 22-23.

me afat të caktuar, ai gjithsesi është shkarkuar me vendim të Qeverisë së SHBA-së dhe sipas ligjeve të SHBA-së, (dhe jo Ligjit të DHSK-së apo Kushtetutës) që kufizonin drejtpërdrejt pavarësinë e tij për veprim, që do të thotë se është shkelje e nenit 35(5) të Ligjit të DHSK-së, siç parashtrohet me Kërkesën e Thaçit.³⁸

C. SHKELJE E PREZUMIMIT TË PAFAJËSISË

16. Përgjigjja e ZPS-së mbron Raportin e Martit³⁹ kundrejt pretendimeve se ai shkel prezumimin e pafajësisë, dhe përfundon se '[ç]dokush që lexon raportin nuk mund të mos ketë përshtypjen se aspektet që diskutohen në raport janë pretendime të paprovuara.'⁴⁰

17. 'Rezerva' në Raportin e Martit se ai nuk është në gjendje të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë nuk mund të pajtohet lehtë me deklarata si: '[g]jithçka na bën të besojmë se të gjithë këta individë do të ishin shpallur fajtorë për krime të rënda dhe sot do të ishin duke vuajtur dënime të gjata në burg'. Në të njëjtin paragraf flitet për 'konsolidimin' e 'pandëshkueshmërisë së tyre'.⁴¹ Gjithashtu në Raport pretendohet se 'në raportet e shërbimeve sekrete për strukturat kosovare të krimit të organizuar të ngjashme me ato të mafies, Thaçi dhe këta pjesëtarë të tjerë të Grupit të Drenicës përmenden vazhdimisht si "lojtarë kryesorë"'.⁴² Marti thotë: 'Unë i kam shqyrtuar këto raporte të ndryshme voluminoze me një ndjenë shtangieje dhe revolte të thellë morale.' Ato që ZPS-ja i quan 'rezerva të kujdesshme' të Raportit të Martit duhen peshuar kundrejt pretendimeve të tilla të papërgjegjshme.

³⁸ Kërkesa e Thaçit, poshtëshënimi. 92.

³⁹ Council of Europe, Parliamentary Assembly, Committee on Legal Affairs and Human Rights, Doc. 12462, 'Report: Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo', 7 January 2011 ("Marty Report"), (Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Komiteti për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Dok. 12462, 'Raport: Trajtimi Çnjerëzor i Personave dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve Njerëzore në Kosovë', 7 janar 2011 ("Raporti i Martit")),

⁴⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 29-31.

⁴¹ Raporti i Martit, para. 69.

⁴² *Po aty*, para. 70.

18. Më pas ZPS-ja pranon⁴³ se Raporti i Martit 'është dokument që është pjesë e kuadrit që drejton juridiksionin e DHSK-së'. ZPS-ja pretendon edhe se '[n]uk ekziston paragjykim në rast se DHSK-ja i referohet një raporti që përmendet në Ligj, apo bëhet një përmbledhje e përmbajtjes së tij'.⁴⁴ Kjo është deklaratë bajate. Në rast se Raporti është paragjykues, atëherë edhe referimi ndaj tij mund të jetë i tillë. Përmendja në ligj e Raportit të një organi politik që nuk bën pjesë në sistemin legjislativ, vendas apo ndërkombëtar, është krejtësisht e pazakontë si dukuri.

19. ZPS-ja më tej e akuzon Mbrojtjen se nuk ka provuar përse 'gjykatësit profesionistë e të pavarur të DHSK-së nuk do të ishin në gjendje ta bënin këtë dallim'.⁴⁵ Megjithëkëtë, jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk ofron ndonjë sugjerim se gjykimi me 'gjykatës profesionistë e të pavarur' mund të ndreqë në njëfarë mënyre shkelje të prezumimit të pafajësisë si pasojë e deklaratave dënuese publike jashtëgjyqësore.

20. Duke argumentuar se Raporti i Martit nuk është 'deklaratë e një përfaqësuesi apo autoriteti të një shteti që ka juridiksion për çështjen',⁴⁶ ZPS-ja keqkupton ose shtrembëron Kërkesën e Thaçit. I parë në vetvete, Raporti i Martit nuk shkel prezumimin e pafajësisë së z. Thaçi në këtë proces gjyqësor. Shkelja lind nga mbështetja që i jepet Raportit nga legjislacioni i zbatueshëm dhe deklaratat e DHSK-së dhe përfaqësuesve të saj që e citojnë këtë Raport. Këto materiale, të marra veças e në tërësi, japin mesazhin se i akuzuari është 'bosi' i një organizate kriminale i cili 'do të ishte shpallur fajtor për krime të rënda dhe do të ishte duke vuajtur dënim të gjatë në burg'. Siç ka konfirmuar GJEDNJ-ja, prezumimi i pafajësisë mbulon 'të gjitha deklaratat e bëra nga një autoritet publik'.⁴⁷

⁴³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 32.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *Po aty*, para. 31.

⁴⁶ *Po aty*, para. 33.

⁴⁷ ECtHR, *Coşkun v. Turkey*, 45028/07, Second Section, Judgment, 28 March 2017, para. 42.

D. SHKELJA E SË DREJTËS PËR GJYKIM BRENDA NJË PERIUDHE TË ARSYESHME

21. ZPS-ja i përmbahet qëndrimit se situata e z. Thaçi 'nuk është ndikuar në mënyrë të qenësishme' deri më 17 nëntor 2019, kur iu dorëzua fletëthirrja. ZPS-ja thotë se para asaj date 'asnjë autoritet kompetent nuk kishte marrë masa duke e njoftuar zyrtarisht THAÇIN se ndaj tij kishte një hetim penal apo masë të tillë që do të kishte ndikuar në mënyrë të qenësishme ndaj tij'.⁴⁸

22. Nocioni i 'autoritetit kompetent' është shpikje e ZPS-së, e pabazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së sa u përket aspekteve që kanë të bëjnë me kriterin e 'ndikimit të qenësishëm'. Në mbështetje të argumentit të saj, ZPS-ja u referohet dy çështjeve gjyqësore, asnjëra prej të cilave nuk është relevante.⁴⁹ E para është një çështje në Itali,⁵⁰ në të cilën është hetuar një gjykatës nga një komision parlamentar. Gjykatësi citoi dispozita të ndryshme të nenit 6 të KEDNJ-së, po jo aspektin e 'periudhës së arsyeshme'. GJEDNJ-ja konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme pasi komisioni parlamentar nuk është gjykatë sipas kuptimit të këtij termi nga neni 6 i KEDNJ-së. Vendimi nuk ka të bëjë me faktin nëse aktivitetet hetimore të organeve jogjyqësore gjatë fazës paraprake të një procesi penal mund të kenë si pasojë që situata e të akuzuarit të 'ndikohet në mënyrë të qenësishme'. Në mënyrë të ngjashme është jorelevante për thelbin e mosmarrëveshjes edhe çështja e dytë gjyqësore që citoi ZPS-ja, *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*.⁵¹ Kjo çështje ka të bëjë me fushëpërfshirjen e termit 'akuzuar për një vepër penale' ku qeveria pretendoi se procesi i përshpejtuar lidhur me mospagesën e një takse vendore nuk mbulohej nga garancitë e gjyqimit të drejtë të nenit 6 të KEDNJ-së.

⁴⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 34.

⁴⁹ *Po aty*, para. 39 dhe poshtëshënimi. 118.

⁵⁰ ECtHR, *Montera v Italy*, 64713/01, First Section, Decision, 9 July 2002.

⁵¹ ECtHR, *Benham v. the United Kingdom*, 19380/92, Grand Chamber, Judgment, 10 June 1996.

23. Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbështet pikëpamjen se një person mund të 'ndikohet në mënyrë të qenësishme' para paraqitjes së akuzave dhe madje edhe para se të fillojë hetimi zyrtar. ZPS-ja nuk e trajton këtë pikë në përgjigjen e saj, pavarësisht se jurisprudenca është e mirënjohur dhe Kërkesa e Thaçit e ka bërë më se të qartë. Në një çështje gjyqësore nga Sllovenia, për shembull, GJEDNJ-ja vuri në dukje se 'procesi paraprak' përfshinte mbledhjen e provave të mjaftueshme 'për t'i mundësuar prokurorit publik të provojë të gjitha elementet e kërkesës për hetim'. GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se 'aktivitetet e policisë gjatë procesit paraprak duhet të kenë ndikuar në mënyrë të qenësishme në gjendjen e parashtruesit të kërkesës në periudhën materiale'. Këto aktivitete përfshinin marrjen e dëshmitarëve në pyetje por jo, mesa duket, të akuzuarin, dhe ato u zhvilluan shumë kohë para se të paraqiteshin akuzat zyrtare.⁵² ZPS-ja pretendon se për shkak se i akuzuari nuk 'ishte marrë në pyetje, kontrolluar, arrestuar apo nënshtruar ndonjë tjetër formë të masave hetimore', situata e tij për pasojë nuk mund të jetë 'ndikuar në mënyrë të qenësishme'.⁵³ Për të mbështetur këtë pohim, nuk citohet asnjë burim nga jurisprudenca e GJEDNJ-së pasi nuk ka të tillë. Për më tepër, është i dobishëm për interpretim kufizimi kohor mbi hetimet penale që kërkon neni 159 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës⁵⁴, pasi pranon ndikimin që hetimet e pafundme mund të kenë mbi të drejtat e të akuzuarit. Z. Thaçi nuk duhet të dëmtohet për shkak se është objekt i juridiksionit të DHSK-së dhe jo një gjykatë të zakonshme në Kosovë.

24. ZPS-ja pretendon se në Raportin e Martit, 'THAÇI identifikohet si një në mes të një numri të madh kryesish të mundshëm të identifikuar apo të paidentifikuar'.⁵⁵ Kjo është deklaratë e pavërtetë. Z. Thaçi përmendet me emër në Raportin e Martit 28 herë. Edhe dhjetë individë të tjerë identifikohen me emër. Së bashku, ata përmenden me

⁵² ECtHR, *Šubinski v. Slovenia*, 19611/04, Third Section, Judgment, 18 January 2007, para. 65.

⁵³ Përgjigja e ZPS-së, para. 37.

⁵⁴ Kodi nr. 04/L-123 mbi Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

⁵⁵ Përgjigja e ZPS-së, para. 36.

emër 31 herë. Është e qartë se z. Thaçi ishte ‘i dyshuari kryesor’ i Raportit të Martit. Për më tepër, ai ishte po ashtu ‘i dyshuari kryesor’ i hetimit të kushtueshëm e të ndërlikuar që zhvilloi TFHS-ja, institucion i cili më pas u bë pjesë e ZPS-së. Edhe Raporti i Martit edhe TFHS-ja janë pjesë e një procesi që ka çuar në ngritjen e akuzave nga ana e DHSK-së. Këtë e bën të qartë faqja e internetit e DHSK-së.⁵⁶

25. ZPS-ja parashtron se e drejta e gjyqimit brenda një periudhe të arsyeshme nuk e mbron individin ‘nga opinion publik apo dyshimi i përgjithshëm’.⁵⁷ Ky është një argument krejtësisht pa vend. Mbrojtja parashtron se autoritetet gjyqësore penale në Kosovë e vunë z. Thaçi nën ‘dyshim të përgjithshëm’ të paktën që nga janari 2011, dhe, për pasojë, situata e tij ‘u ndikua në mënyrë të qenësishme’, moment ky që shënon fillimin e procesit i cili i jep të drejtën e gjyqimit brenda një ‘periudhe të arsyeshme’.

26. Në rast se DHSK-ja pajtohet se i akuzuari ‘u ndikua në mënyrë të qenësishme’ para nëntorit 2019, siç parashtron Mbrojtja, ZPS-ka ka detyrimin të ofrojë prova ose shpjegim për të kundërshtuar supozimin se nuk është respektuar standardi i ‘periudhës së arsyeshme’. GJEDNJ-ja gjithnjë ka këmbëngulur se shtetet përgjegjëse duhet të shpjegojnë vonesat pasi, në rast të kundërt, ajo mund të arrijë në përfundimin se kishte pasur shkelje. Në një çështje e cila ishte vonuar për gjashtë vjet, Dhoma e Madhe vërejti se ‘Qeveria nuk dha shpjegim për këtë vonesë, e cila është qartësisht e tepruar’.⁵⁸ Ajo ka thënë se ‘nuk mund t’i trajtojë si të arsyeshme periudhat e gjata të mosveprimit të pashpjeguar’,⁵⁹ duke konfirmuar se i takon shtetit të shpjegojë arsyet e vonesave. Në një çështje tjetër gjyqësore, GJEDNJ-ja konstatoi

⁵⁶ *Shih p.sh.* “Dokumente Themeluese” ku renditet Raporti i Martit, i cili gjendet në: <https://www.scp-ks.org/en/documents/foundational-documents>; përmbledhja e përgjithshme e Task Forcës Hetimore Speciale, që gjendet në: <https://www.scp-ks.org/en/spo/special-investigative-task-force>.

⁵⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 38.

⁵⁸ ECtHR, *Frydlender v. France*, 30979/96, Grand Chamber, Judgment, 27 June 2000, para. 44.

⁵⁹ ECtHR, *Sociedade de Construções Martins & Vieira, Lda. And Others v. Portugal*, 56637/10, 59856/10, 72525/10, 7646/11 and 12592/11), First Section, Judgment, 30 October 2014, para. 47.

shkelje sepse ‘Qeveria nuk ka dhënë shpjegim të besueshëm për vonesën’.⁶⁰ Edhe në një çështje tjetër, ajo vuri në dukje se ‘Qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim për të justifikuar një periudhë kaq të gjatë mosveprimi’.⁶¹

27. I vetmi shpjegim që ofron ZPS-ja është se për arsye të ndryshme kjo është një çështje e ndërlikuar gjyqësore. Siç është parashtruar në Kërkesën e Thaçit, GJEDNJ-ja asnjëherë nuk ka pranuar se nëntë vjet janë ‘të arsyeshme’ për hetim dhe gjykim. Në gusht 2014, z. Uilliamson la të kuptohej se hetimet në thelb kishin përfunduar. Kryetare Trendafilova, më 18 janar 2019, tha se ‘[p]as tre vjetësh, Kryeprokurori i TFHS-së, Klint Uilliamson, njoftoi se provat e mbledhura kishin peshë të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës’.⁶² Nuk është dhënë asnjë shpjegim për pesë vitet që kaluan deri në lëshimin e fletëthirrjes. Gjithashtu, ZPS-ja nuk trajton as parashtrimin e Kërkesës së Thaçit se për këtë vonesë mund të ketë kontribuar edhe largimi i menjëhershëm dhe i papritur i Prokurorit Shvendiman.⁶³ Ky është të paktën përfundim i arsyeshëm kur nuk është emëruar zëvendësuesi.⁶⁴

28. Për shkak se detyrimin për të shpjeguar e ka ZPS-ja, Gjykata duhet të mendojë se koha e shkuar bën që të mos përmbushet standardi i nenit 6(1) të KEDNJ-së. Për më tepër, mosdhënia e shpjegimit dëshmon se ZPS-ja shpërfill të drejtën e të akuzuarit për t’u gjykuar brenda një ‘periudhe të arsyeshme’. Është e pabazuar përpjekja e ZPS-së për të kërkuar kohë për përgatitjen e argumenteve të saj për shkak të kërkesave të

⁶⁰ ECtHR, *Vergelsky v. Ukraine*, 19312/06, Fifth Section, Judgment, 12 March 2009, para. 120. See also ECtHR, *Azyukovska v. Ukraine*, 47921/08, Fifth Section, Judgment, 17 December 2019, para. 39.

⁶¹ ECtHR, *Cuško v. Latvia*, 32163/09, Fifth Section, Judgment, 7 December 2017, para. 40.

⁶² Jan Lhotský, ‘Intervistë me Kryetaren e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Ekaterina Trendafilova: Gjykata është Gati për Aktakuzat e Para’, 18 janar 2019.

⁶³ Kërkesa e Thaçit, para. 27.

⁶⁴ See, e.g. Dick Marty, *Une certain idée de la Justice* (Favre, 2018), p. 257: “Alors que le nouveau procureur, aussi américain, s'apprête à communiquer les noms des personnes mises en accusation, un nouveau coup de théâtre a lieu: le procureur David Schwendiman s'en va! De prétendues dissensions avec le Département d'Etat quant à son statut seraient à l'origine de ce départ abrupt. Le procès va donc subir un autre retard et les questions sur le sérieux de la mission d'EULEX se posent une fois de plus.”

mbrojtjes.⁶⁵ Duke shpërfillur të drejtën e të akuzuarit për ‘kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij’, siç përcaktohet në nenin 6(3)(b) të KEDNJ-së, ZPS-ja thotë se është normale dhe e arsyeshme që hetimi i saj të zgjasë nëntë vjet, por që hetimi i mbrojtjes të zgjasë tetëmbëdhjetë muaj nuk është normale dhe e arsyeshme.

[Numri i fjalëve (në origjinal): 4621]

Parashtruar me respekt,

/nënshkrimi/

Dejvid Huper

Mbrojtës i Specializuar për Hashim Thaçin

14 maj 2021

Në Londër, Mbretëria e Bashkuar

⁶⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 41: “Është kuptimplotë fakti se, me këtë pretendim për shkelje të të drejtave, Mbrojtja e THAÇIT kërkon të mbështetet në kërkesën e saj të pabazuar që gjykimi të mos fillojë edhe për 18 muaj të tjerë si pjesë e periudhës së kohës që duhet marrë parasysh.”